

# FoodShare



## WISCONSIN

A Recipe for Good Health



## Rregullat themelore të punës së FoodShare për aplikantët dhe anëtarët e FoodShare nga moshë 16 deri në 59 vjeç

(FoodShare Basic Work Rules for FoodShare Applicants and Members Ages 16 Through 59)

### Cilat janë rregullat themelore të FoodShare?

Rregullat federale kërkojnë që aplikantët dhe anëtarët e FoodShare të moshave 16 deri në 59 vjeç të ndjekin rregullat bazë të punës së FoodShare. Kur plotësoni një aplikim në FoodShare ose rinovoni përfitimet tuaja, ju pajtoheni që të ndiqni rregullat themelore të punës së FoodShare dhe jeni të regjistruar për punë.

Rregullat bazë të punës së FoodShare janë të ndryshme nga kërkesa e punës në FoodShare për disa të rritur të moshave 18 deri në 54 vjeç, të cilët nuk kanë fëmijë në shtëpi.

Nëse nuk ndiqni rregullat bazë të punës së FoodShare dhe nuk keni përjashtim, nuk do të mund të merrni përfitimet e FoodShare për një periudhë kohore. Kjo quhet një periudhë sanksioni.

Nëse keni nevojë të ndiqni rregullat bazë të punës, duhet:

- Jepni agjencisë tuaj statusin tuaj të punësimit ose aftësinë për të punuar.
- Mos hiqni dorë nga një punë prej të paktën 30 orë në javë dhe pa shkak të arsyeshëm (ose një punë me të ardhura javore prej \$217.50 dollarë ose më shumë).
- Mos të ulni orët e punës tuaj nën 30 orë në javë pa shkak të arsyeshëm (përveç nëse keni pagesa javore prej \$217.50 ose më shumë).

- Të pranoni një ofertë pune nëse ju ofrohet një punë që është e përshtatshme.
- Plotësoni kërkesat e punës së programit të kompensimit të papunësisë nëse keni aplikuar ose po merrni përfitime papunësie.
- Plotësoni kërkesat e pjesëmarrjes në Wisconsin Works (W-2) nëse jeni duke marrë pjesë në W-2.

### Cilat janë përjashtimet nga rregullat bazë të punës së FoodShare?

Ju përmbushni një përjashtim nga ndjekja e rregullave themelore të FoodShare nëse **është** e vërtetë një nga këto:

- Jeni 16 ose 17 vjeç dhe nuk jeni personi kryesor në familjen FoodShare.
- Jeni 16 ose 17 vjeç dhe jeni personi kryesor në familjen FoodShare, por jeni të regjistruar në shkollë ose në një program punësimi dhe trajnimi të paktën në gjysmë kohe.
- Keni vërtetuar që nuk jeni i aftë për të punuar. Kjo aplikohet nëse:
  - Ju merrni përfitime të përkohshme ose të përhershme të paaftësisë nga qeveria ose një burim privat.
  - Jeni vërtetuar se jeni psiqikisht ose fizikisht i paaftë për të punuar nga agjencia juaj.
  - Ju jeni verifikuar si i paaftë për të punuar me një deklaratë nga një profesionist i kujdesit shëndetësor ose punonjës social.



- Ju jeni regjistruar në W-2 dhe jeni në përputhje me kërkesat e pjesëmarrjes në W-2.
- Jeni personi kryesor që kujdeset për një fëmijë të varur nën moshën 6 vjeç (pa marr parasysh nëse fëmija jeton në shtëpinë tuaj ose jashtë shtëpisë suaj). Megjithatë, nëse ju dhe një person tjetër keni të dy kontrollin prindëror të fëmijës, vetëm njëri prej jush mund të përjashtohet nga kërkesat e regjistrimit të punës si kujdestari kryesor i atij fëmije.
- Ju jeni kujdestari kryesor për një person tjetër që nuk mund të kujdeset për veten e tij ose të saj (pa marr parasysh nëse personi jeton në shtëpinë tuaj ose jashtë shtëpisë suaj).
- Ju keni aplikuar ose po merrni kompensim papunësie.
- Po merrni pjesë në një program trajtimi ose rehabilitimi të alcohol or other drug abuse (abuzimit me alkool ose me drogë) (AODA).
- Ju jeni duke punuar 30 ose më shumë orë në javë ose po fitoni paga javore prej \$217.50 dollarë ose më shumë.
- Jeni të regjistruar të paktën në mes të kohës në një shkollë të njohur, program trajnimi ose institucion të arsimit të lartë.

Mund t'ju duhet t'i jepni prova agjencisë suaj nëse përmbushni një nga këto përjashtime.

## Çfarë ndodh nëse nuk zbatoj rregullat bazë të punës dhe nuk plotësoj një përjashtim?

Nëse nuk ndiqni rregullat bazë të punës dhe nuk përmbushni një përjashtim, nuk do të jeni në gjendje të merrni përfitimet FoodShare për një periudhë të caktuar sanksioni. Kjo përfshin nëse vullnetarisht dhe pa shkak të arsyeshem bëni ndonjë nga këto:

- Refuzoni një ofertë pune të përshtatshme.
- Lini një punë prej 30 ose më shumë orë në javë (ose një punë me të ardhura të barabarta me 30 ose më shumë orë në javë me pagën minimale federale).
- Ulni orët tuaja të punës në më pak se 30 orë në javë (ose të ardhurat tuaja në më pak se 30 herë paga minimale federale).
- Merrni pjesë në W-2 por nuk përmbushni kërkesat e programit W-2.

- Aplikoni për ose merrni përfitime papunësie por nuk përmbushni kërkesat e programit të të punës për kompensimin e papunësisë.

## Çfarë ndodh nëse e humbi një përjashtim?

Nëse humbni një përjashtim, atëherë duhet të ndiqni kërkesat e rregullave bazë të punës FoodShare. Nëse humbisni një nga përjashtimet e mëposhtme pa arsye të mirë, nuk do të mund të merrni përfitimet e FoodShare për një periudhë të caktuar sanksioni, përveç nëse keni një përjashtim tjetër:

- Ju jeni regjistruar në W-2 dhe jeni në përputhje me kërkesat e punës W-2.
- Ju keni aplikuar ose po merrni kompensim papunësie.
- Ju jeni duke punuar 30 ose më shumë orë në javë ose duke fituar paga të barabarta me 30 ose më shumë orë në javë me pagën minimale federale.

## Sa zgjat periudha e sanksionit?

Kohëzgjatja e një periudhe sanksionimi varet nëse keni pasur një sanksion më parë.

- Periudha e parë e sanksionit është një muaj.
- Periudha e dytë e sanksionit është tre muaj.
- Periudha e tretë ose e mëpasshme e sanksionit zgjat gjashtë muaj.

## A mund ta përfundoj para kohe një periudhë sanksioni?

Ju mund ta përfundoni një periudhë sanksionimi më herët nëse përjashtoheni nga kërkesat e regjistrimit të punës.

## Pasi të përfundojë periudha ime e sanksionit, si mund ta marr sërish FoodShare?

Ju do të duhet të riaplikoni. Nëse jeni pjesë e një grupi FoodShare, do t'ju duhet të njoftoni punonjësën tuaj për të përditësuar çështjen tuaj në vend se të aplikoni përsëri.

## Çfarë do të thotë arsye e mirë?

Arsye e mirë do të thotë se ekziston një situatë jashtë kontrollit tuaj që ju pengon të përmbushni kërkesat e regjistrimit të punës. Nëse nuk keni arsye të mirë,

mund të mos jeni në gjendje të merrni përfitimet e FoodShare për periudhën e caktuar të sanksionit. Nëse keni arsye të mirë, do të mund të vazhdoni të merrni përfitimet e FoodShare. Punonjësi juaj do të shqyrtojë situatën tuaj për të përcaktuar nëse ka pasur një arsye të mirë.

Disa shembuj të për arsye të mirë janë:

- Ju nuk pranuat një ofertë pune, ose u larguat nga puna, sepse puna nuk ishte e përshtatshme.
- Ju u pushuat ose u larguat me kërkesë të punëdhënësit.
- Ju jeni diskriminuar nga një punëdhënës në bazë të moshës, racës, gjinisë, ngjyrës, aftësisë së kufizuar, bindjeve fetare, origjinës kombëtare ose bindjeve politike.
- Jeni larguar nga puna për një punë, trajnim ose shkollë tjetër.
- Nuk keni mundur të vazhdoni një punë sepse jeni shpërngulur.
- Problemet tuaja shëndetësore, apo problemet shëndetësore e të tjerëve, nuk ju lejuan të vazhdoni punën tuaj.
- Orari juaj i punës u reduktua nga punëdhënësi juaj pa lejen tuaj.
- Jeni larguar nga një punë për t'u bashkuar me një program vullnetar si AmeriCorps ose AmeriCorps VISTA.

- Nuk kishit mjet transporti për të shkuar në punë.
- Ju nuk keni pasur kujdes për një fëmijë më të vogël se 12 vjeç.
- Kishte situata të tjera jashtë kontrollit tuaj që agjencia mendon se ishin arsye të mira.

## Si mund të mësoj më shumë?

Për më shumë detaje në lidhje me kërkesat e regjistrimit të punës, kontaktoni agjencinë tuaj ose referojuni manualit të regjistrimit dhe përfitimeve, [www.dhs.wisconsin.gov/publications/p0/p00079.pdf](http://www.dhs.wisconsin.gov/publications/p0/p00079.pdf). Për të gjetur agjencinë tuaj, shkoni te [www.dhs.wisconsin.gov/forwardhealth/imagency/index.htm](http://www.dhs.wisconsin.gov/forwardhealth/imagency/index.htm), ose telefononi Shërbimet e Anëtarëve në 1-800-362-3002 (TTY dhe shërbimet e përkthimit janë të disponueshme).

**Shënim:** Kërkesat e rregullave bazë të punës FoodShare janë të ndryshme nga kërkesat e punës FoodShare për të rriturit e moshave 18 deri në 54 vjeç. Referojuni FoodShare Wisconsin: Kërkesa e punës për të rriturit e moshës 18 deri në 54 fletë të dhënash (P-00710) për më shumë detaje rreth kësaj kërkesë. Fleta e të dhënave është në dispozicion në [www.dhs.wisconsin.gov/publications/p0/p00710.pdf](http://www.dhs.wisconsin.gov/publications/p0/p00710.pdf).

## Deklaratë për mosdiskriminim

Në përputhje me ligjin federal për të drejtat civile dhe rregulloret dhe politikat e të drejtave civile të U.S. Department of Agriculture (Departamentit të Bujqësisë së SHBA-së) (USDA), ky institucion është i ndaluar të diskriminojë bazuar në racë, ngjyrë, origjinë kombëtare, gjininë (përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual), besimin fetar, aftësinë e kufizuar, moshën, bindjet politike, ose hakmarrjen ose kundërshtimin për aktivitetin e mëparshëm të të drejtave civile.

Informacioni i programit mund të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera përveç anglishtës. Personat me aftësi të kufizuara të cilët kërkojnë mjete alternative të komunikimit për të marrë informacionin e programit (p.sh. Alfabetit 'Braille' printim të madh, audio, gjuha amerikane e shenjave), duhet të kontaktojnë agjencinë (shtetërore ose lokale) ku kanë aplikuar për përfitime. Individët të cilët janë të shurdhër, kanë vështirësi në dëgjim ose kanë probleme me fjalën (shprehjen) mund të kontaktojnë Departamentin e Bujqësisë së SHBA-së (USDA) përmes Federal Relay Service (Shërbimit Federal të Komunikimit) në (800) 877-8339.

Për të paraqitur një ankesë për diskriminim në program, një person që ankon duhet të plotësojë Formularin AD-3027, Formularin për Ankesë për Diskriminim në Program të USDA-së, i cili mund të merret online në:

<https://www.usda.gov/sites/default/files/documents/ad-3027.pdf>, nga çdo zyrë e USDA-së, duke telefonuar në

(833) 620-1071, ose duke shkruar një letër të adresuar te USDA. Letra duhet të përmbajë emrin e personit që ankon, adresën, numrin e telefonit dhe një përshkrim të shkruar të veprës pretendimisht diskriminuese në mjaftueshëm detaje për të informuar Assistant Secretary for Civil Rights (Asistentin Sekretar të të Drejtave Civile) (ASCR) në lidhje me natyrën dhe datën e pretenduar të shkeljes së të drejtave civile. Formulari ose letra e plotësuar AD-3027 duhet të dorëzohet në:

- (1) **postë:**  
Food and Nutrition Service, USDA  
1320 Braddock Place, Room 334  
Alexandria, VA 22314; ose
- (2) **faks:**  
(833) 256-1665 ose (202) 690-7442; ose
- (3) **email:**  
[FNSCIVILRIGHTSCOMPLAINTS@usda.gov](mailto:FNSCIVILRIGHTSCOMPLAINTS@usda.gov)

Ky institucion është një ofrues i shanseve të barabarta.

2/15/2023